

Përfaqësimi i drejtë në sektorin publik në Maqedoninë e Veriut: me trendin aktual, përfaqësimi adekuat i komuniteteve do të mund të arrihet në vitin 2055

Hyrje

“Barometri i Përfaqësimit të Drejtë”, një projekt i zbatuar nga Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi me mbështetjen e Bashkimit Evropian, ka mbledhur të dhëna për përfaqësimin e komuniteteve dhe të grave në institucionet publike në periudhën 2014-2022, bazuar në raportet e Avokatit të Popullit.

Përveç paraqitjes së numrave të përgjithshëm rreth përfaqësimit të drejtë, Barometri llogarit indekse të ndryshme që vlerësojnë përmbushjen e parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, në numra unik nga 0-10, të krahasueshëm ndër vite dhe ndërmjet institucioneve. Indekset e përfaqësimit të drejtë kalkulohen sipas strukturës demografike të popullsisë, bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2021.


Analiza e mëposhtme paraqet një pasqyrë të përgjithshme të përfaqësimit të komuniteteve dhe të grave, duke përfshirë aspektet që janë të pranishme, por jo të përmbledhura në formë grafike dhe të dukshme në faqen e internetit të Barometrit:

<https://barometri.ipp-arbenxhaferi.org/>

Tendencat e përgjithshme

Grafikët e mëposhtëm tregojnë gjendjen e përfaqësimit në periudhën 2014-2022, si për përfaqësimin e komuniteteve ashtu edhe për atë gjinor. Këto indekse përfshijnë të gjithë trupin e punonjësve të sektorit publik.

Indeksi i përfaqësimit të komuniteteve 2014-2022



Siç mund të shihet në historinë e indeksit të komuniteteve, ka një tendencë të përgjithshme përmirësimi, pasi indeksi lëviz nga 5,9 në vitin 2014 në 6,7 më 2022. Duke pasur parasysh atë që përfaqëson indeksi, një mënyrë për të menduar për këtë është se në vitin 2014 përfaqësimi ishte 59% e përfaqësimit adekuat, ndërsa në vitin 2022 ishte 67%. Gjatë një periudhe 8-vjeçare përmbushja e parimit të përfaqësimit të drejtë u përmirësua për 8%, ose 1% në vit.


Nëse trendi aktual vazhdon, atëherë përfaqësimi adekuat i komuniteteve në fuqinë e përgjithshme punëtore të sektorit publik do të arrihet për 33 vjet, ose rreth vitit 2055.

Në pozitat drejtuese, indeksi i komuniteteve është disi më i ulët, duke treguar se ende ekziston një mospërputhje ndërmjet përfaqësimit të përgjithshëm të komuniteteve dhe përfaqësimit të tyre në pozita udhëheqëse. Indeksi lëviz nga 4,5 më 2014 më 5,4 në 2022. Ky është një përmirësim i ngjashëm me indeksin e përgjithshëm, duke lëvizur me një normë prej afërsisht 1% në vit.

Me trendin aktual, përfaqësimi adekuat i komuniteteve në pozita udhëheqëse do të arrihet pas 46 viteve, ose rreth vitit 2068.

Megjithatë, duhet të theksojmë se përfaqësimi adekuat është një gjendje ideale, e cila gjithsesi nuk do të arrihej për arsye praktike, ndër tjera për shkak të evoluimit të strukturës demografike të popullsisë së përgjithshme.

Indeksi i përfaqësimit gjinor 2020-2022



Indeksi gjinor është mjaft i kënaqshëm, të paktën në krahasim me përfaqësimin e komuniteteve. Indeksi gjinor u përmirësua nga 9,6 në 2020 në 9,8 në 2022 dhe është fare afër përfaqësimit adekuat. Indeksi u përmirësua me një normë prej 1% në vit.

Kur është fjala për indeksin gjinor për postet drejtuese, ai është disi më i ulët se indeksi i përgjithshëm, por shumë afër një gjendje ideale. Indeksi i lidershit u përmirësua nga 9,1 në 2020 në 9,6 në 2022. Ky është një përmirësim prej 5% gjatë tre viteve, pra me një ritëm më të shpejtë se indeksi i përgjithshëm i përfaqësimit gjinor.


Nisur nga këto tendenca, është e arsyeshme të pritet që hendeku gjinor në pozitat drejtuese të mbyllet shumë shpejt, deri në atë pikë sa të mos jetë më problem, të paktën në nivel të përgjithshëm.

Tendencat e përfaqësimit sipas komuniteteve

Lëvizja e indeksit të përfaqësimit të komuniteteve e përshkruar më lartë varet shumë nga lëvizjet në komunitetin maqedonas dhe atë shqiptar, si dy bashkësitë më të mëdha, që përbëjnë pothuajse 90% të popullsisë. Pra, nëse duam të shohim zhvillimin e përfaqësimit të komuniteteve të tjera, më të vogla, duhet të vlerësojmë secilën prej tyre individualisht.

Duke pasur parasysh përqindjen e punonjësve të secilit komunitet dhe përqindjen e tyre në popullsinë e përgjithshme, është e mundur të shihet se sa është përmbushur përfaqësimi i tyre thjesht duke pjesëtuar përqindjen e punonjësve me përqindjen e popullsisë për secilin komunitet.

Përmbushja e përfaqësimit në nivel të përgjithshëm sipas komunitetit 2014-2022



Grafiku i mësipërm tregon përfaqësimin e secilit komunitet në vitin 2014 dhe në vitin 2022, krahasuar me përqindjen e tij në popullsinë e përgjithshme. Kjo tregon qartë se disa komunitete, përkatësisht maqedonasit, serbët dhe vllahët, e kishin përmbushur prej kohësh përfaqësimin e tyre në institucionet publike, ndërsa të tjerat, përkatësisht shqiptarët, turqit, romët dhe boshnjakët kanë qenë vazhdimisht dukshëm të nënpërfaqësuar.

Grafikët tregojnë gjithashtu se gjatë 8 viteve të fundit ka pasur një tendencë të përgjithshme ku pothuajse të gjitha komunitetet lëvizin drejt përqindjes së tyre reale në popullatën e përgjithshme. Përfaqësimi shqiptar dhe boshnjak është përmirësuar me rreth 1% në vit. Megjithatë, është shqetësuese që përfaqësimi i romëve është ulur nga viti 2014 në 2022.

Kur bëhet fjalë për përfaqësimin e përgjithshëm të komuniteteve në sektorin publik në periudhën 2014-2022 është, situata si vijon:

Community	Representation in percentage 2014	Representation in percentage 2022	Percentage in the general population
Macedonians	74,8	71,9	57,9
Albanians	18,6	21,4	31,5
Turks	1,9	2,1	4,2
Roma	1,4	1,3	2,5
Serbs	1,6	1,4	1,3
Vlachs	0,7	0,6	0,5
Bosnians	0,4	0,1	0,9
Others	0,8	0,7	1,2

Të njëjtat tendenca shfaqen në pozitat drejtuese, por këtu mospërputhjet janë edhe më dramatike.

Për shembull, komuniteti serb dhe ai vllah janë dukshëm të mbipërfaqësuar në pozita udhëheqëse dhe këto trende kanë qenë në rritje në periudhën 2014-2022.

Ka përmirësim në përfaqësimin e komuniteteve të tjera, por duhet theksuar se në disa raste shifrat janë të zymta. Për shembull, përmbushja e përfaqësimit të komunitetit rom në pozita drejtuese është vetëm 12% në vitin 2022.


Në përgjithësi, ka një tendencë drejt përmirësimit edhe në pozitat udhëheqëse për të gjitha komunitetet. Megjithatë, hendeku midis përfaqësimit në pozitat drejtuese në krahasim me përfaqësimin e përgjithshëm është mjaft i lartë dhe do të duhet një kohë shumë më e gjatë për të arritur përfaqësimin adekuat.

Megjithatë, siç u tha më lart, si indekset e përgjithshme ashtu edhe ato të lidershit janë të ndikuar shumë nga trendet në komunitetin maqedonas dhe atë shqiptar.

Duke qenë se të dyja këto po ecin në mënyrë të qëndrueshme drejt objektivave të tyre, me një normë të përafërt prej 1% në vit, vetë indekset lëvizin me afërsisht të njëjtën normë. Sidoqoftë, është e nevojshme të mbahen evidenca e asaj që

ndodh me komunitetet e tjera, siç u tregua në grafikët e mësipërm. Një shqetësim i veçantë duhet të jenë komunitetet më pak të përfaqësuara, siç është komuniteti rom.

Përmbushja e përfaqësimit në pozita drejtuese sipas komunitetit 2014-2022



Situata kur bëhet fjalë për përfaqësimin e përgjithshëm të komuniteteve në pozita udhëheqëse në sektorin publik në periudhën 2014-2022 është si vijon:

Community	Representation in percentage 2014	Representation in percentage 2022	Percentage in the general population
Macedonians	80,7	76,8	57,9
Albanians	14,1	16,3	31,5
Turks	1	1,7	4,2
Roma	0,2	0,3	2,5
Serbs	2	2,4	1,3
Vlachs	0,9	1,1	0,5
Bosnians	0,5	0,5	0,9
Others	0,8	0,8	1,2

Konkluzion

Indeksi i përgjithshëm i përfaqësimit të drejtë të komuniteteve është 6,7 dhe indeksi i përfaqësimit të komuniteteve në pozita drejtuese është 5,4. Të dy indekset lëvizin me një normë prej rreth 0,1, ose rreth 1% në vit.

Indekset gjinore tregojnë një nivel të kënaqshëm përfaqësimi, duke qenë përkatësisht 9,8 dhe 9,6. Krahasuar me vitin 2020 kur të dhënat e Avokatit të Popullit janë publikuar për herë të parë, këto indekse gjithashtu tregojnë përmirësim, dhe është veçanërisht inkurajuese që indeksi i leadershipit gjinor po përmirësohet më shpejt se indeksi i përgjithshëm. Në një studim të ardhshëm, do të ishte interesante të shihej se si zberthehet përfaqësimi gjinor sipas sektorëve të veçantë.

Veç kësaj, ndarja sipas komuniteteve veç e veç tregon se disa komunitete kanë qenë historikisht të nënpërfaqësuara, por se ka një tendencë përmirësimi.

Përrjashtim bën komuniteti rom, i cili tani është më pak i përfaqësuar se sa në vitin 2014 dhe përfaqësimi i të cilit në pozitat drejtuese është mjaft dëshpërues.

Në përgjithësi, ekziston një hendek midis përfaqësimit të përgjithshëm dhe përfaqësimit në pozitat udhëheqëse, që do të thotë se komunitetet e nënpërfaqësuara janë edhe më të nënpërfaqësuara në pozita udhëheqëse.

Kontakt

E-mail: info@ipp-arbenxhaferi.org
Web: www.ipp-arbenxhaferi.org